



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

S E S I O N I II

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Pasaktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuara gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA II**Viktor Hygo****Katedralja e Parisit**

Pyetja 14	D	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	C	1 pikë

Pyetja 21 (a) 1 pikë

- 1 pikë** Në katedrale mbizotëron vetëm drejtësia hyjnore. Drejtësia njerëzore atje s'ka vend. Katedralja është vendi i perëndisë dhe vetëm ajo ka të drejtë të vendosë drejtësi atje.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (b) 3 pikë

- 1 pikë** Të dy janë të mohuar nga shoqëria, të veçuar dhe të përbuzur prej saj. Kanë ngjashmëri shpirtërore.
- 2 pikë** Kuazimodo po e shpëton Esmeraldën nga duart e drejtësisë, po e shpëton nga ndëshkimi për diçka që ajo nuk e ka bërë. Esmeralda e bën Kuazimodon më njerëzor, më të butë, më të dashur. E ndihmon të kuptojë se është njeri, me ndjenja dhe emocione. Të dy ndajnë mohimin dhe braktisjen që u është bërë.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 (a) 2 pikë

- 1 pikë** **Figura e stilistikës:** metafora ose metaforë e hiperbolizuar.
- DHE**
- 1 pikë** **Interpretimi:** Ashtu sikurse rrufeja lëshon shkrepitima dhe një dritë të fuqishme, edhe syri i Kuazimodos shkrepitinte duke i dëshmuar botës refuzimin e tij dhe këmbënguljen për ta mbrojtur deri në fund vajzën. Metafora e hiperbolizuar tregon pikërisht forcën e tij të jashtëzakonshme për ta mbrojtur Esmeraldën dhe për të *djegur*, ashtu si rrufeja, këdo që do guxonte ta prekte.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (b) 2 pikë

- 1 pikë** **Gjendja shpirtërore:** *fatkeqe, i përbuzur, i madhërishtëm, të fortë, etj.*
- DHE**
- 1 pikë** **Pamja e jashtme:** *buçitës, e shëmtuar, të vrazhda, të ashpra, çipa- çipa, ciklopi, leshatake, etj.*
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Kuazimodo është një njeri i vrazhdë, i shëmtuar, me një forcë të jashtëzakonshme, por nga ana tjetër ai ka një shpirt të ndjeshëm, njerëzor. Pra një njeri kaq i përçudnuar ka një shpirt kaq bujar.
- **Ilustrimi:** *shprehte kësaj butësi, ëmbëlsi, dhembshuri - duke lëshuar shkrepitima, duarve të tij të vrazhda - por e mbante me aq kujdes, etj.*

1 pikë Nëse shpjegon kontrastin mbi të cilin ngrihet figura e Kuazimodos.

DHE

1 pikë Nëse gjen një ilustrim që tregon thelbin e këtij kontrasti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Kuazimodo po sfidon shoqërinë që e ka neveritur, mohuar, përbuzur, tallur e sflitur për kaq kohë. Ai po i tregon kësaj shoqërie se ai mund t'i dalë kundër dhe nuk e ka frikë aspak.
- Ai po triumfon mbi drejtësinë njerëzore, duke i rrëmbyer asaj Esmeraldën, duke mos e lënë ta ndëshkojë. Ai po triumfon mbi çdo gjë të padrejtë që kjo shoqëri përfaqëson.

1 pikë Nëse tregon ku qëndron sfida më e madhe e Kuazimodos.

1 pikë Nëse tregon se mbi çfarë po triumfon ai.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **2 pikë****Model përgjigjeje****Karakteristika të romantizmit:**

- shkrimi sugjestionues i Hygoit shkakton emocione të fuqishme përmes përshkrimeve;
- kthesat e befasishme;
- kontrastet e fuqishme;
- figurat e stilistikës të preferuara për romantikët si: *metafora, hiperbola, antiteza*;
- Etj.

2 pikë Nëse zbulon në fragmentin e dhënë dy karakteristika të romantizmit bashkë me ilustrimet përkatëse.

OSE

1 pikë Nëse zbulon në fragmentin e dhënë një karakteristik të romantizmit bashkë me ilustrimin përkatëse ose zbulon dy karakteristika por pa ilustrimet përkatëse.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.